

FJALA E DEPUTETES KLOTILDA BUSHKA

E ENJTE 31 MARS 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Përpara se të filloj të diskutoj në lidhje me masat e qeverisë për përballimin e pasojave të krizës në ekonominë tonë, që vijnë nga lufta në Ukrainë, nuk rri dot pa përmendur faktin se sot kam dëgjuar shumë kolegë të opozitës, të cilët u referohen ngjarjeve të fundit lidhur me arrestimin e një ish-deputeti, si një çështje që etiketon të gjithë shumicën qeverisëse, duke u bërë hetues, prokurorë, si dhe duke i kërkuar drejtësisë, me shantazhe, që të mos jetë drejtësi me regji. Të gjitha këto që bëni tregojnë se nuk keni besim te drejtësia, nuk e doni këtë drejtësi të re.

Mos harroni, megjithëse edhe po harruat ju, nuk harrojnë qytetarët, se ishte kjo shumicë qeverisëse, Partia Socialiste, që i hapi rrugë reformës në drejtësi, ku nuk ka më të paprekshëm, ku kultura e pandëshkueshmërisë do të vdesë, siç ka filluar të duket çdo ditë në çdo çështje që po ndiqet. Çfarë vendosi kjo qeveri? Vendosi heqjen e imunitetit për ndjekje penale të zyrtarëve të lartë. Ka qenë kjo shumicë qeverisëse, e cila pati vullnetin për ta bërë reformën dhe sot ka vullnetin për ta jetësuar atë. Drejtësia duhet lënë e lirë, e pavarur dhe efiçente që të veprojë. Ne këtu këtë po bëjmë. Ju nga kjo anë e sallës, ju të opozitës, nuk mund të bëni hetuesin dhe prokurorin, nuk mund të bëni as gjyqtarin; është drejtësia ajo që duhet lënë të veprojë. Ndaj po ju them se, me të gjitha paragjykimet që keni dhe me të gjithë baltën që hidhni, ajo që duhet të bëni është të besoni se çdokush është i barabartë përpara ligjit, që do të thotë se të gjithë duhet të hetohen.

Sot në SPAK ka çështje që janë duke u hetuar, ku shumë janë nga ana juaj, ashtu siç ka edhe zyrtarë të tjerë po nga kjo anë, që janë në hetim. Por ne të gjithë, nëse e duam drejtësinë, nëse ju e doni drejtësinë, duhet të besojmë te drejtësia dhe ta lini atë deri në fund të veprojë, derisa të jepen vendimet e formës së prerë, duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë; por nëse ju bëheni gjyqtarë, nëse ju flisni, nëse ju bëheni prokurorë dhe jepni verdikte, ju nuk e doni drejtësinë. Nëse e doni drejtësinë, lëreni atë të punojë e pavarur. Në fakt, ajo drejtësi e pavarur do t'i japë përgjigje edhe "21 janarit", edhe "Gërdecit", edhe vjedhjeve të energjisë me aferat e CEZ-it, edhe privatizimeve të paligjshme të kryera në vite, do t'i japë përgjigje çdolloj afere tjetër, e cila sot është nën hetim. Unë besoj se e vetmja gjë, që mund të bëjë politika është të mbajë distancë nga drejtësia. Kështu që, lërin këto emocione që keni, sepse po të ishte për drejtësinë, e dimë sesi mbylleshin gjyqet dhe sesi mbylleshin çështjet kur ishit ju në pushtet, sa e turpshme.

Kur erdhëm në pushtet në vitin 2013 e pamë se çfarë ndodhte, sesi ishte procesi, sesi po rrënohej drejtësia. Kjo na detyroi të ndërmerrim një reformë në drejtësi, e cita tashmë është në rrugën e vet tashmë të pandalshme dhe do t'i japë përgjigje të drejtë, ashtu siç duhet, si në çdo vend demokratik, çdo çështjeje. Po i kthehem rendit të ditës, për të cilin ju kam dëgjuar me keqardhje. Më duket si një

retrospektivë e 4 çështjeve që ka kaluar kjo qeveri gjatë të gjithë kohës së saj në pushtet dhe fjalimet tuaja janë një përsëritje e baltës dhe e llumit që hidhni këtu. Ne, në fakt, kemi kaluar dy tërmete, jo një. Kemi kaluar pandeminë dhe tani po përballojmë një krizë tjetër, që është krizë ekonomike dhe sociale.

Çdo veprim, çdo nismë që kemi ndërmarrë, që ka rezultuar e suksesshme, gjithmonë e kemi kundërshtuar me të njëjtën gjuhë që kemi folur edhe sot. E pra, ja ku jemi, me veprimet që ne kemi ndërmarrë, qytetarët i kanë ndjerë efektet pozitive, ia kemi dalë me 2 tërmetet, ia kemi dalë me pandeminë, ashtu siç do t'ia dalim edhe këtë herë, sepse, ne ndryshe nga ju, kolegë të opozitës, nuk punojmë me populizëm, nuk punojmë me emocione, nuk punojmë me papërgjegjshmëri, por punojmë në bazë të analizave, ne punojmë në bazë të përgjegjshmërisë dhe mendojmë jo sot për sot, por mendojmë të jemi në një situatë të qëndrueshme, ashtu si në shtëpi kur na bie një hall. Çfarë, do t'i biem me top, siç tha zonja Kumbaro, të bëjmë gati zarfet për njerëzit që janë në nevojë?! Jo, pra, se për këtë na kanë zgjedhur qytetarët dhe na kanë votuar dhe rivotuar për përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin që kemi. Ajo që na sugjerohet sot me aktin normativ është e drejtë.

Bazuar te rritja ekonomike që ka vendi, bazuar tek të ardhurat e realizuara 2 muajt e parë të vitit 2022, patjetër që do të bëjmë një rishpërndarje të fondeve, duke pasur në fokus pikërisht financimin e nevojave për të përballuar krizën ekonomike sociale të atyre, që janë grupet më në nevojë të shoqërisë. Për këtë arsye e kemi menduar me shumë kujdes, në fakt, unë e përgëzoj qeverinë që ka dhënë 3,3 miliardë lekë për indeksimin e pensioneve. Ajo vlerë që indeksohet sot te pensionet është pikërisht çështja që ka të bëjë me uljen e efekteve të rritjes së çmimeve që vijnë për pensionistët. Pjesa tjetër, që është shumë e rëndësishme, janë 1,45 miliardë lekë mbështetje për fermerët për naftë pa taksë. Dëgjova sot të thoni se po bëjmë shpërndarje të naftës në mënyrë elektorale. Por ligjet kanë kritere të qarta për ata që përfitojnë. Nëse juve ju vjen keq që deputetët tanë shkojnë dhe i ndihmojnë qytetarët si të aplikojnë, si të gjejnë rrugën për t'i orientuar, pse nuk e bëni edhe ju këtë gjë? Kush ju ka ndaluar? Cilët janë ata qytetarë që e ndiejnë se ne i paskemi ndarë: "Ca të nënës dhe ca të njerëzës"? Jo, nuk është e vërtetë. Kjo që thoni është thjesht një abuzim, hidhni një tymnajë këtu.

Në fakt, e vërteta është që sot fermerët do të marrin naftë pa taksë; e vërteta është që produktet bujqësore dhe eksportet bujqësore janë rritur. Nëse do të ishte keqmenaxhuar apo nuk do të kishin funksionuar politikat tona, nuk do të ishim sot me këto shifra, sepse shifrat janë fakte. Opinionet tuaja, aq më tepër përbaltjet tuaja, nuk ngjisin. Njerëzit kanë sy, kanë vesh dhe i ndiejnë efektet e politikave tona në përditshmërinë e tyre. Janë 567 mijë familje në nevojë që do të marrin 3 mijë lekë në muaj, për 3 muaj. Më falni, thoni që është pak?! Por jua shpjegoi edhe ministrja e Ekonomisë, edhe zonja Ekonomi, ministrja tjetër, të gjithë kolegët e mi sot, që kjo vlerë është për të kompensuar pikërisht rritjen e çmimeve si pasojë e inflacionit. Jua bënë edhe llogaritë: kjo shumë është 2 mijë e 500 lekë, por do të jepen 3 mijë lekë. Ku është problemi me këtë çështje, që nuk po arrini ta kuptoni? Çfarë është buxheti i shtetit, makinë prodhimi parash?! Jo, buxheti i shtetit realizohet nga të ardhurat që vijnë nga taksat dhe nga tatimet, pastaj është përgjegjësi e qeverisë t'i menaxhojë ato në mënyrën e duhur, që të shpërndahen në të gjithë sektorët sipas nevojave, sipas prioriteteve dhe, aq më tepër, në kohë krizash ne të kemi një arkë plot, e cila mund të na shërbejë në këto raste.

Ju thoni 3 mijë lekë janë pak apo janë shumë, por nëse i ndajmë këto para, atëherë si u bëkan politikat kështu? Kjo është detyra e qeverisë, të menaxhojë me analiza, me përgjegjësi dhe, sipas mundësive që ne kemi, u jemi përgjigjur rritjes së çmimeve sa është vlera e inflacionit, për t'ua dhënë këtyre 567 mijë familjeve. Pse thoni që ne nuk kemi ulur taksa? Çfarë takse t'i ulim biznesit të vogël, kur e ka 0 edhe tatimin, edhe TVSH-në? E keni parë në rajon sa është taksa e biznesit të vogël, se ngelët duke krahasuar Shqipërinë me rajonin? Në rajon biznesi i vogël e ka taksën nga 10% deri në 16%, ndërsa në Shqipëri biznesi i vogël nuk e paguan këtë taksë. Ne nuk do t'i ulim taksat dhe akcizën e naftës, pra këto që thoni ju, sepse ne, në bazë të analizave dhe në bazë të filozofisë qeverisëse, do të punojmë, siç kemi punuar deri më sot, për qëndrueshmërinë financiare të buxhetit të shtetit, që ai të plotësojë nevojat e të gjithë popullsisë, duke pasur prioritet ata që janë më në nevojë dhe të tjerët në mënyrë proporcionale. Ne sigurisht që kemi ulur taksa: 0 taksë për pagat deri në 40 mijë lekë, tani do ta miratojmë me këtë akt normativ. Kemi përgjysmuar taksën për ata me pagë deri në 50 mijë lekë.

Gjithashtu, ulja e taksës mbi pagat nga 150 mijë deri në 200 mijë lekë është pjesë e politikës fiskale për uljen e barrës fiskale për këto çështje. Të mos harrojmë energjinë elektrike. Asnjë qytetar sot, që është familjar apo biznes i vogël, nuk e përballon dot vetë çmimin e energjisë elektrike nëse do t'u faturohej sa është realisht çmimi, por ai paguan njësoj saç paguante përpara se të ndodhte kriza energjetike. Më falni, në qoftë se do t'i jepnim faturën sot aq sa kushton, është disafish më e lartë. Këtë e përballon shteti me 28 miliardë lekë. Unë këtu u bëj thirrje të gjithë qytetarëve, që e kanë këtë lehtësi nga shteti, të kursejnë sa të munden. Me të drejtë Kryeministri tha: ne po përpiqemi sa mundemi me përgjegjshmëri që të ndjekim këtë politikë, por nuk e dimë sa do të vazhdojë kriza, ndaj të gjithë së bashku, na ka zënë ky hall në shtëpinë tonë, nuk është momenti t'i tregojmë gishtin njëri-tjetrit dhe të themi që juve ju ra. Po, po, neve na ra. Neve na kanë rënë shumë kriza, në fakt, i kemi përballuar me përgjegjësi, do të vazhdojmë t'i përballojmë me përgjegjësi, sepse ne detyrën e kemi karshi qytetarëve, të cilëve do t'u shërbejmë deri në fund. Faleminderit!